

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë,

Në fakt, unë dua të bëj një ndërhyrje, që mendoj se na shërben në diskutim. Po të shikojmë fokusin që kemi vënë ne si qeveri socialiste në zhvillimin rural, unë dua t'ju bëj me dije se aktiviteti bujqësor zhvillohet brenda fshatit dhe në fshat ka familje që merren me aktivitet bujqësor dhe familje që nuk merren me aktivitet bujqësor. Në qoftë se shikojmë, shifrat e INSTAT-it vlerësojnë që familjet rurale të jenë rreth 450 000 dhe familjet që janë kthyer në njësi ekonomike-bujqësore vlerësohet të jenë rreth 350 000.

Duke thënë këto shifra, dua të tregoj se qeveria shqiptare fshatin vazhdimisht e ka në krye të vëmendjes për disa arsye, po investon në rrugë rurale, po investon në ujë, që familjet të kenë më shumë ujë, por, gjithashtu, po investon për të zhvilluar të gjithë infrastrukturën, ku të gjitha këto familje rurale të zhvillojnë aktivitetin e tyre për t'u kthyer në njësi ekonomikebujqësore. Në fakt, ajo që ka ndodhur në këto vite është që ne i kemi dhënë përparësi shumë të madhe një investimi horizontal, investimi që kemi bërë në ujitje dhe në kullim.

Mjafton t'ju them që investimet në ujitje dhe në kullim janë investime afatgjata dhe nuk e bëj për krahasimin, por në vitin 2013 ishin nën ujë vetëm 155 mijë hektar dhe sot janë 255 mijë hektarë, si dhe vazhdimisht investohet në ujitje dhe në kullim, në kanale kullese, në kanale vaditëse, në diga dhe në argjinatura. Ky vendim për investime infrastrukturore është i pakthyeshem. Nevojat janë të mëdha dhe investimet janë të vazhdueshme. Përveç kësaj, investimet që bëhen në rrugët rurale për të ndihmuar familjet rurale, natyrisht që u shpërbejnë edhe njësive ekonomike - bujqësore.

Këto njësi ekonomike - bujqësore, ju e dëgjuat edhe nga parafolësi, ndahen në 3 kategori të rëndësishme, sepse të dhënat për Shqipërinë tregojnë që madhësia mesatare e fermës është e vogël, është 1,2 hektar. Në 1,2 hektar nuk mund të ndodhin gjëra të mëdha. Gjithashtu, kemi një fat të madh, që jemi ndihmuar gjithmonë nga donatorë të ndryshëm, qofshin këta

gjermanë, italianë, zviceranë, Bashkimi European edhe të tjerë, me të cilët kemi filluar të strukturojmë fermën.

Në strukturimin e fermës kemi kuptuar se ka nga ata fermerë që bëjnë autokonsum, ka nga ata që bëjnë autokonsum, por dalin edhe në tregun e brendshëm, ka edhe nga ata që prodhojnë për tregun e brendshëm, por dhe për eksport. Në gjithë këtë veprimtari, shumë i rëndësishëm është produktiviteti. Kështu që, investimet tona janë drejtuar drejt produktivitetit. Fatin e madh e patëm kur Shqipëria përqafoi programin e IPARD-it. IPARD-i mundësoi investime për të rritur produktivitetin.

Nuk ishim gati në IPARD-et e kaluara, tek i pari dhe tek i dyti, që të përfshinim shumë masa, por në IPARD-in e tretë, që qeveria sapo e lançoi, ne kemi përfshire 9 masa, sepse edhe bujqësia është bërë gati, edhe njësia ekonomike-bujqësore është bërë gati të përqafojë më shumë nga ndihma që jep Bashkimi European. Çfarë ka ndodhur në fakt? Qeveria ka menduar për mënyrën sesi po investohet. Për shembull, skema e naftës bëri diçka shumë të rëndësishme, jo vetëm që u dha naftën fermerëve, por legalizoi fermerët shqiptarë. Fermerët shqiptarë sot kanë NIPT. Ne kemi 60 000 fermerë që kanë NIPT.

Unë besoj se e gjithë kjo shihet si një arritje e fermerit, e mbështetur edhe nga qeveria. Ndërsa për ata që i quajmë “fermerë të mesëm”, se ende nuk kanë arritur në atë standard, ne kemi skemën e mbështetjes direkte, që i mbështesim për prodhime, qofshin bujqësore apo blegtorale, për ato skema që ju dëgjuat të diskutohet sot. Ndërsa për ata fermerë që duan të bëjnë investime në infrastrukturë, ndërhyr IPARD-i, i cili kërkon një kompani fermere serioze me të cilën punon. Thënë kjo, dua të tregoj se e gjithë vëmendja është për të zhvilluar një bujqësi kompetitive edhe në këtë rajonin tonë të vogël, sepse po të bëjmë një krahasim me vitin 2017, eksportet bujqësore janë rritur me 33, 3% dhe janë rritur shumë eksportet që vijnë nga sektori i peshkut, me rreth 32% dhe eksportet që vijnë nga agro-përpunimi, që janë rritur me rreth 24%. Kjo është situata që kemi tani.

Nga ana tjetër, ne kemi dëshirën e madhe të bëhemi pjesë e Bashkimit European. Bashkimi European sektorin e bujqësisë e ka të rregulluar me një politikë që e quan Commune Agriculture Policy CAP. CAP-i është një gjë e madhe, është për të gjitha vendet, por ama në qendër ka që

duhet të krijohet një treg paneuropian, ku marrin pjesë të gjitha vendet, në një këtë treg ku lëvizin të gjitha produktet europiane dhe përpiqen të kenë çmime të unifikuara për produktet, si dhe duke mbrojtur produktet e origjinës, produktet gjeografike tipike.

Tani, duke punuar për këtë gjë, vëmë re që marrëveshjet tona për të përmirësuar CAP-in dhe për ta sjellë atë në realitetin shqiptar, nuk kanë qenë shumë të larta, janë 18%. Ndaj strategjia që po punohet sot, është një strategji që ka parasysh atë që ka ndodhur dhe gjitha politikat e CAP-it deri në vitin 2017. Kështu që, mendoj se propozimet që kanë ardhur sot për këtë projektligj, janë propozime të drejta, se natyrisht që ligji ka nevojë të rishikohet, sepse është rishikuar CAP-i, është rishikuar politika e Bashkimit Europian për zhvillimin rural, por në momentin kur ne nuk jemi gati dhe kur nuk dimë se ku do të shkojmë me strategjinë, besoj se nuk mund ta reflektojmë ndryshimin menjëherë në ligj.

Duke ju thënë këtë, dua të shtoj edhe diçka tjetër: respekti për fermerët është i jashtëzakonshëm, sepse ata punojnë përditë, edhe në kushtet e vështira të motit, edhe në kushtet e këtij presioni shumë të madh që vjen nga tregu ndërkombëtar. Nga ana tjetër, edhe grumbulluesit kanë një punë të jashtëzakonshme, sepse ata përhapin mes fermerëve një kulturë pune, që nuk është parë ndonjëherë, me një cilësi shumë të lartë, prandaj produktet shqiptare sot po shkojnë në shumë tregje.

Pra, është për t'u përgëzuar iniciativa e grumbulluesve, që i ka çuar produktet shqiptare në më shumë se 80 tregje ndërkombëtare. Unë besoj se për shumë nga ne, kur udhëtojmë jashtë vendit dhe shikojmë që ka një produkt "Made in Albania" është krenari. Për shembull, në Suedi shkon bamja edhe kungulli shqiptar. Apo edhe kur hamë vaj ulliri në Amerikë, besoj se është krenari dhe është respekt për të gjithë fermerët që e kanë prodhuar këtë produkt, por edhe për grumbulluesit që kanë bërë të mundur që ato prodhime të shkojnë në ato shtete. Unë besoj se bujqësia është një nga gjërat më të rëndësishme, me të cilën ne do të merremi vazhdimisht, sepse fermerët përfaqësojnë gjysmën e popullsisë shqiptare dhe kanë nevojë për vëmendjen e qeverisë në mënyrë të vazhdueshme.

Prandaj, edhe investimet infrastrukturore që bëhen në bujqësi, por edhe mbështetja sipas 3-4 kategorive të fermave, për ne janë shumë të rëndësishme. Faleminderit!